

KONKURS PËR MATURANTËT

RREGULLORJA

- **ORGANIZUESIT**

Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” organizon një konkurs për të gjithë maturantët e shkollave të mesme të Shqipërisë.

Në konkurs përfshihen Fakultetet e Mjekesisë, Farmacisë, Ekonomisë dhe Arkitekturës.

Tema për çdo Program Studimi është:

Fizioterapi:

“Stili i jetës dhe roli i fizioterapisë.”

Infermieristikë:

“Kuroj dhe kujdesem për të tjerët.”

Farmacit:

“Rëndësia e njohjes së sistemit biologjik ose biokimik për ndërhyrjen në patologjitë njerëzore.”

Ekonomi:

“Efektet juridike dhe ekonomike të Pandemisë Covid-19.”

Arkitekturë:

“Shtëpia ime në 2030-ën.”

- **Shtrirja gjeografike e konkursit**

Konkursi do të shtrihet në të gjithë shkollat e mesme të Shqipërisë duke përfshirë të gjithë maturantët. Numri i maturantëve fitues për çdo Program Studimi do të jetë si më poshtë:

Fizioterapi: 10 fitues

Infermieristikë: 10 fitues

Farmacit: 10 fitues

Ekonomi: 10 fitues

Arkitekturë: 20 fitues

Numri total i fituesve në të gjithë Shqipërinë do të jetë 60.

- **Mënyra e zhvillimit**

Punimet e përgatitura nga maturantët duhet të jenë individuale dhe duhet të dërgohen me e-mail në adresat si më poshtë:

Fizioterapi: e.prendi@unizkm.al, f.spada@unizkm.al, info@unizkm.al

Infermieristikë e.gjini@unizkm.al, e.voicuolguta@prof.unizkm.al, info@unizkm.al

Farmacit: e.bej@unizkm.al, info@unizkm.al

Ekonomi: b.karra@unizkm.al, info@unizkm.al

Arkitekturë: k.galica@unizkm.al, c.architettura@unizkm.al, info@unizkm.al

Ose me postë në adresën: Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”, Rruga “Dritan Hoxha”, 123, Laprakë –Tiranë.

Në subjekt të e-mailit shkruani emrin e Programit të Studimit dhe titullin e konkursit për të cilin aplikoni psh: Arkitektura “Shtëpia ime në 2030-ën”.

Në e-mail shkruani:

Emër, Mbiemër

Shkolla

Qyteti

Numër telefoni

- **Kohëzgjatja e konkursit**

Maturantët kanë kohë të dërgojnë punimet e tyre nga data **11 Janar 2021** deri më **31 Mars 2021**.

- **Përfundimi dhe shpallja e fituesve të konkursit**

Konkursi do të përfundojë më 31 Mars 2021 dhe komisioni i vlerësimit për çdo program studimi do të shpallë fituesit në **“OPEN DAY”**, prill 2021.

- **Mënyra e shpërndarjes së çmimeve**

Komisioni i vlerësimit për çdo Program Studimi do të vlerësojë maturantët fitues.

Çmimet do të shpërndahen gjatë Open Day, prill 2021 dhe do të njoftohen në rrjetet sociale dhe në faqen web të Universitetit.

Në rast se aktiviteti Open Day do të zhvillohet online, çmimet do të shpërndahen me anë të postës.

- **Çmimet e konkursit**

Fituesit e konkursit do të vlerësohen me këto çmime:

- 1) Ulje 30% nga tarifa vjetore e Programit të Studimit të përzgjedhur të Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” për të gjithë maturantët që regjistrohen në vitin e parë akademik 2021-2022. Ulja do t’i shtohet bursës së studimit në bazë të mesatares për nxënësit që regjistrohen në vitin e parë pranë Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”. (Psh. Në rast se maturanti me mesatare 10 është fitues i konkursit, atëherë bursa e tij e studimit për vitin e parë mund të arrijë deri në 100%).
- 2) Çantë me dhurata.

- **Regjistrimet në Universitetin Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”**

Të gjithë fituesit e konkursit të maturantëve për t’u regjistruar në Universitetin Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” duhet të kenë një mesatare të notave të shkollës së mesme të barabartë ose më të lartë se 7, sipas dekretit nr.436 të datës 03.06.2020 të Ministrisë së Arsimit.

Fituesit e konkursit të Programeve të Studimit në Fizioterapi dhe Infermieristikë duhet t’i nënshtrohen testimit hyrës me të gjithë kandidatët e tjerë të interesuar. Vetëm pas kalimit të testit mund të vazhdojnë me regjistrimin.